



Naša uprava

institut alternativa



ADMINISTRATA PUBLIKE DERI NË VITIN 2020



PËR ADMINISTRATË PUBLIKE NË SHËRBIM TË QYTETARËVE

Deri në vitin 2020 duhet të realizohet vizioni i Administratës në Mal të Zi si një servis për qytetarët.

Objektivat e veçanta të Strategjisë së Administratës Publike në këtë fushë janë:

EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET MË I LARTË SI DHE KËNAQËSI MË E MADHE E QYTETARËVE ME CILËSINË E SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE TË OFRUARA



Qytetarët e Mali të Zi rrallë pyesin për cilësinë e shërbime që iu ofrohet nga Administrata Publike. Me zbatimin e Strategjisë qytetarët duhet të përfitojnë trajtimin që meritojnë. Efiçenca ka të bëjë me vet procesin e ofrimit të shërbimeve, i cili duhet të jetë më i shkurtër dhe më i thjeshtë. Ndërsa efektiviteti nënkupton cilësinë e mirë të ofrimit të shërbimeve.

PORTALI I E-ADMINISTRATËS DUHET TË PËRMIRËSOHET
(<http://www.euprava.me/>)

Portali i eAdministratës u krijua si një sportel elektronik për qasje në shërbimet administrative. Qeveria ka premtuar se shumë shërbime do jenë në dispozicion në këtë portal. Përveç kësaj, shërbimet e përzgjedhura nuk duhet të jenë në dispozicion vetëm të nivelit të dhënies së informacionit, por edhe në nivele më të larta siç është për shembull shkarkimi dhe plotësimi i formularëve.



REGJISTRAT E NDRYSHËM TË TË DHËNAVE QË POSEDON ADMINISTRATA, DUHET TË PËRPUTHEN DHE LIDHEN NË MES VETI, NË MËNYRË QË PËRDORUESIT TË SHËRBIMEVE TI LEHTËSOHET QASJA NË INFORMACIONIN E NEVOJSHËM



Qytetarëve shpesh iu duhet të bredhin sa nga njëri sportel në tjetrin me qëllim për të realizuar të drejtat e tyre. Shpesh këtë e bëjnë nga fillimi, pas çdo kontakti të ri me administratën. Strategjia e re duhet t'i lehtësojë këtë punë. Në korrik të vitit 2017 do të hyjë në fuqi Kodi i Procedurave Administrative, i cili do të lehtësojë dukshëm kontaktin e qytetarëve me administratën. Ky ligj sjell detyrimin për organet administrative që informacionin e nevojshëm për vendimmarrje në procedurat administrative, ta mbledhin vetë nga dokumentet dhe regjistrat zyrtarë, sipas detyrës zyrtare.



Kjo broshurë u krijua në kuadër të projektit 'Shoqëria Civile për Qeverisje të Mirë: Shërbim dhe Meritë', që financohet nga Bashkimi Evropian dhe implementohet nga Instituti Alternativa, Bonum, Natura, Horizonti i Ri dhe Qendra për Gazetari Hulumtuese. Përmbajtja e kësaj broshure është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet qëndrimet e Bashkimit Evropian.